

UNITED
NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/27
Prishtinë, më 9 tetor 2003, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Nfye **Gas**, anëtare e Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 96 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Rendi i ditës, për këtë seancë, ishte vazhdimi i seancës së mëparshme.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.
2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për shërbime postare-nr.2003/19;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe të mjedisit të punës-nr.2003/20;
4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit legjislativ për amendamentimin e Rregullorës së përkohshme të punës së Kuvendit;
5. Shqyrtimi i propozimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurial të Kosovës për emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve; dhe
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare më 16 tetor 2003.

Kryetari kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohet sipas këtij rendi të ditës.

1.Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

Arsim Bajrami theksoi se seanca e kaluar është mbyllur në mënyrë arbitrare, pa u lejuar që Parlamenti ta thotë fjalën e vet.Ai,në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së,kërkoi të vazhdohet debati lidhur me pikën e parë të seancës së kaluar dhe të arrihet një konsensus institucional, i cili do të legjitimohet nga Kuvendi.Kuvendi duhet të mbetet i konvokuar edhe gjatë ditëve të ardhshme,derisa të arrihet një koncesus dhe të marrë një qëndrim politik për negociatat e mundshme ndërmjet Kosovës dhe Unionit SMZ në Vjenë.Ai kërkoi që Kuvendit t'i drejtohenkreu i UNMIK-ut,z.Holkeri dhe kryetari i Kosovë t'i paraqesin para deputetëve përgatitjet lidhur me takimin e Vjenës.

Bujar Dugolli, në emër të Grupi Parlamentar të AAK-së tha se partitë politike,nënshkruese të marrëveshjes politike për bashkëqeverisje nuk kanë arritur konsensusin për negociatat e mundshme ndërmjet Kosovës dhe Unionit SMZ dhe është e panevojshme të debatohet për një çështje që nuk ka konsensus ndërpartiak.Ai shtoi se nuk ka koncensus pa kompletimin e Qeverisë me ministrinë e jashtme,të rendit dhe të drejtësisë,si dhe bartjen e kompetencave nga UNMIK-u tek institucionet vendore.

Kryetari tha se në takimin e mbëmshëm me Holkerin dhe Quintin nuk është arritur pajtushmëri që keru i UNMIK-ut dhe kryetari i Kosovës t'i drejtohen Kuvendit.Ka qenë një takim serioz dhe shumë përmbajtësor,në të cilin përfaqësuesit e Quintit kanë një ndihmesë në kapërcimin e problemit që është në rend të ditës.Kryeministri,mbrëmë e ka pasur përkrahjen e plotë të të gjithë përfaqësuesëve të Kosovës dhe është arritur një avancim i madh me UNMIK-un lidhur me kërkesar e drejta dhe reale që i shroi në atë takim,kryeministri.

Hashim Thaqi tha se është oferta shumserioze e komunitetit ndërkombëtar për vërien e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Institucionet e Kosovës kanë qenë serioze në diskutimet e tyre rreth këtij problemi shumë të rëndësishëm për të ardhmen e vendit. Kam theksuar edhe më herët se koncensusin duhet ta ruajm si sytë e ballit për hirë të interesave të qytetarëve të Kosovës. Por, natyrisht se duhet të diskutohet për çfarë konsensusi të arrihet? Konsensusi për pavarësinë e Kosovës, apo konsensus për procesin që në fakt e largon Kosovën nga rruga për pavarësi. Nëse vëhet në votim një propozim, atëherë ai duhet të jetë:A është Kuvendi i Kosovës për vërien e dialogut me Serbinë apo jo?

Në takimin e mbëmshëm,shtoi ai, ka kërkuar që në këtë seancë të jetë i pranishëm edhe kryetari i Kosovës, kryeministri i Kosovës dhe t'i drejtohen deputetëve për të sqaruar se cila është platforma e delegacionit të Kosovës për takime me Serbinë? Cilat janë prioritetet?Cila është oferta dhe pozicioni i palës kosovare në takimin e Vjenës?Dhe në bazë të këtyre kritereve, Kuvendi i Kosovës duhet të marrë qëndrim të qart politik, shumë serioz dhe të jetë në përputhshmëri të plotë me interesat e qytetarëve të vendit.

Kryetari e vuri në votim propozimin e Gupit Parlamentar të PDK-së lidhur me vazhdimin e diskutimeve për pikën e parë të seancës së kaluar.Rezlutati ishte si vijon:

Për-----26.

Kryetari konstatoi se nuk përkrahet propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së.

Bujar Dugolli tha se Grupi Parlamentar i AAK-së abstenon në këtë votim dhe nuk dëshiron të rreshtohen “pro” atij grupi apo “kundër” këtij grupi. Ai kërkoi të respektohet procedura e votimit për propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së. Qëndrimi jonë, shtoi ai që të abstenojmë për vazhdimin e diskutimit të seancës së mëparshme, e konsiderojmë shterpë, ngase nuk ka konsensus ndërpartiak lidhur me takimin e Vjenës

Arsim Bajrami theksoi se për çështjen e takimit të Vjenës, duhet të gjindet një koncesus i brendshëm dhe të mos merren vendimet vetëm me anë të votimeve.

Hydajet Hyseni theksoi se Kuvendi i Kosovës duhet të merrë qëndrim koncesual për takimin e Vjenës dhe bëri vërejtje në procedurën e votimit.

Kryetari e përmbylli diskutimin lidhur me këtë çështje me konstatimin se nuk përkrahet propozimi i Grupit Parlamentar i PDK-së dhe deklaroi një pauzë prej 15 minutash.

Senca i vazhdoi punimet pas pauzës me pikën e dytë të rendit të ditës-

2. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për shërbime postare-nr.2003/19.

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me raportet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit funksional në këtë p/ligj dhe i vuri në votim amendamentet një nga një.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20,21,22 dhe 23.

Kryetari e vuri në votim P/ligjin në tërësi dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----12;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për shërbime postare.

3. Shqyrtimi i dytë i p/ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarëve dhe mjedisit të punës-nr.2003/20.